



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 560/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkritazi me ankesat e Partia Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) me Anr.560/2013 dhe 561/2013 dega në Fushë Kosovë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar dy ankesa më datë 04.11.2013, nga subjekti politik PDK dega në Fushë Kosovë, njëri nga ata është Enver Bytyqi i cili deklaroi se në vendvotimin e shkollës fillore në Bardh ka votuar me 36 anëtarë të familjes së tij për Z. Fehmi Ramadani kandidat i PDK-së për këshilltar komunal, vota të cilat janë shpallur të pavlefshme, ndërsa ankesa tjetër është Migjen Berisha vëzhgues i PDK në fshatin Bardh i cili deklaroi se bashku me familjen e tij ka votuar me 22 vota për kandidatin e PDK-së Z. Fehmi Ramadani, por të cilat dyshon se janë bërë të pavlefshme nga komisioni zgjedhor i këtij vendvotimi edhe dyshon në 260 vota tjera të kandidatin e lartëcekur janë shpallur të pavlefshme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesat gjeti se:

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore nga dy ankesat Anr.560/2013 dhe 561/2013 e subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës Dega në Fushë Kosovë janë të pabazuara pasi që dëshmitë e ofruara janë të përgjithshme dhe të paqarta për të cilat nuk mund të vërtetohen pretendimet ankimore.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur shkeljet dhe parregullsitë nga antarët i KVV të qendrës së vendvotimit në shkollën fillore në fshatin Bardh të Fushë Kosovës. PZAP-i, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesat e lart përmendura u refuzuan si të pa bazuara. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 560/2013 më datën 07.11.2013.



**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*